



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINA SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË



Duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr-03/L-040 dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr-03/L-049, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur më datë: 25 shtator 2008 aprovoi këtë:

RREGULLORE

PËR TARIFAT, NGARKESAT DHE GJOBAT NGA SHERBIMET DHE VEPRIMTARIT KOMUNALE

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

QËLLIMI

Neni 1.

Me këtë rregullore caktohet lartësia e tarifave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime nga veprimtaritë komunale, që do t'i paguajnë personat fizikë dhe juridikë, në emër të shërbimeve komunale, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe tregtare, lejeve për punë profesionale, për pronësi të automjeteve, të përdorimit apo shfrytëzimit të pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, për shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale.

II LARTËSIA E TARIFAVE DHE NGARKESAVE

Neni 2.

Lartësia e ngarkesave që do të paguajnë personat fizikë e juridikë, në emër të shërbimeve apo veprimtarive komunale sipas drejtorive, në pajtim me këtë Rregullore, do të jenë, si vijon:

Neni 3.

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT

Nr./Ren. i Tarifës	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)		Norma tatimore në Euro " € "			
			Vendim 2007	Propozimi i DAP-it	Propozimi i KPF-së	Aprovimi i KK-së
Sektor i përgjithshëm		Për pranimin e kërkesës	0.50	0.50		
		Vërtetimi i fotokopjes-formati A4x1	0.50	0.50		
		Vërtetimi i fotokopjes-formati A3x1	1.00	1.00		
		Për fotokopjimin dhe vërtetimin e identitetit nga arkivi.	2.00	3.00		
		Vërtetimi i deklaratës mbi raportin e lidhjes familjare	1.00	2.00		
		Vërtetimi i deklaratës qe personi është i vetëm	1.00	1.00		
		Vërtetimi i deklaratës mbi vendqëndrimin e përkohshëm	1.00	1.00		
		Vërtetimi i deklaratës mbi varshmërin materiale	1.00	2.00		
		Për huazimin e dokumenteve te lejueshme nga arkivi	5.00	5.00		
		Vërtetimi i deklaratës mbi nacionalitetin (etnicitetin) e qytetarit	1.00	2.00		
		Vërtetimi i deklaratës qe nuk gjendet ne marrëdhënie pune	1.00	1.00		
		Vërtetimi i deklaratës mbi mbikëqyrjen e anëtarit te familjes	1.00	1.00		
		Vertetimi i deklaratave te ngjashme mëvarsisht nga kushtet momentale	1.00	2.00		

		Vërtetimi i deklaratës mbi jetën e përbashkët deri ne vdekjen e bashkëshortit.	1.00	1.00		
		Për përkthimin e dokumenteve - (për faqe)	5.00	5.00		
		Për përpilimin e autorizimit - pëlqimit	5.00	5.00		
		Për përpilimin e kërkesave, deklaratave etj	2.00	2.00		
		Për vërtetim të autorizimit – pëlqimit	2.00	2.00		
		Për ankesë kundër vendimit të cilin e bie organi i shkallës së parë, paguhet tarifa në shumën prej:	1.00	2.00		
	Certifikatat – Sektori I Ofiqarisë	Kërkesa për certifikatë të lindjes	1.00	1.00		
		Kërkesa për certifikatë të martesës	1.00	1.00		
		Kërkesa për certifikatë të vdekjes	Pa pagesë			
		Për akt vdekje (trashëgimia)	5.00	5.00		
		Për ceremonialin e lidhjes se martesës	5.00	5.00		
		Për regjistrimin e mëvonshëm te faktit te lindjes	10.00	10.00		
		Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes	Pa pagesë			
		Për ndërrimin e emrit personal (deri në moshën 18 vjeçare) (mbi moshën 18 vjeçare)	10.00 20.00	10.00 50.00		
		Për korrigjimin e shënimeve në librat amëz	5.00€	5.00		
		Për lidhje te martesës jashtë orarit te punës	20.00	20.00		
		Për lidhje te martesës jashtë selis së Komunës	50.00	50.00		
		Për lidhje te martesës, kur njeri bashkëshort është shtetas i huaj	50.00	50.00		
		Për deklaratë te bashkësisë familjare-për përdorim ne Kosovë	1.00	1.00		
		Për deklaratë te bashkësisë familjare jashtë Kosove	5.00	5.00		
		Për regjistrimin në librat special te lindjeve, martesave-jashtë Kosovës	2.00	2.00		
		Për vërtetimin e shtetësisë	2.00	2.00		
		Për vërtetimin qe personi është në jetë	5.00	5.00		
		Për certifikatë te statusit te lire martesor	5.00	5.00		
		Për vërtetim te vendbanimit ose vërtetime tjera	1.00	1.00		
	Për konfirmim lënda e martesës, me kërkesë të DRGJC	3.00	3.00			
	Për konfirmim te certifikatave, LAL, LAM e tjera	0.50	1.00			
	Për lidhje te martesës me shtetas te huaj-jashtë orarit te punës	70.00	70.00			

	Për lidhje te martesës me shtetas te huaj jashtë orarit dhe jashtë selis se komunës.	100.00	100.00		
	Për personin zyrtar ne lidhje te martesës (jashtë orarit dhe jashtë selis) nga pala duhet te behet kompensimi për mëditje ne shumë prej:	20.00	20.00		
	Personat dhe Subjektet e liruar nga participimi ne shërbimet e Drejtorisë për Administratë dhe Personel				
	Rastet sociale (Dëshmia nga Qendra për punë sociale – vlefshmëria e kartelës)				
	Familjarët e Dëshmorëve te luftës (Prindit, Bashkëshortet, dhe fëmijët deri ne moshën 18 vjeçare)				
	Invalidët e luftës (vendimi nga Organi kompetent mbi shkallen e Invaliditetit)	Mbi 50%			
	Familjaret e viktimave te luftës				
	Personat e hendikepuar	Mbi 50%			

Zyra e prokurimit

Tarifa për pjesëmarrje në tender për një operator	25.00
---	-------

Neni 4.

Tarifë (ngarkesat) për ushtrimin e veprimtarisë afariste

DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Komuna cakton lartësinë e tarifë ngarkesave për çdo subjekt afarist të cilët merren me ushtrimin e veprimtarisë ekonomike brenda kufijve të komunës. Përcaktimet e detyrimeve bëhen vetëm pasi subjekti afarist paraqet dëshmi të mjaftueshme si provë për regjistrimin e subjektit në institucionin përgjegjës. Lartësia e përcaktimit të tarifë ngarkesave përcaktohet konform rregullores e miratuar nga Kuvendi i komunës.

Ngarkesat për leje të biznesit apo veprimtari afariste dhe grumbullimi i tarifave të paguara mund të aplikohen në kohën kur një veprimtari e tillë zhvillohet në komunën e Suharekës por vetëm në ato instanca në të cilat biznesit dhe veprimtaria afariste janë të realizuara në pajtim me rregulloret ku paraqiten kërkesat për shfrytëzimin e tokës, shëndetësisë dhe lejeve të sigurisë, kërkesat për shërbime publike si dhe rregulloreve të tjera aplikuese për biznesin dhe veprimtarinë afariste.

Për përcaktimin e ngarkesave dhe lëshimin e lejeve lidhur me grumbullimin e këtyre tarifave është bërë edhe klasifikimi i biznesit dhe veprimtarisë afariste si në vijim:

Veprimtarit ekonomike

Nr./Ren. i Tarifës	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Norma tatimore në Euro " € "			
		Vendimi 2007	Propozimi i DEFZH	Propozimi i KPF-së	Aprovimi i KK-së
1.	Subjektet afariste në pronësi shoqërore, individuale që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet biznesor si deklarues të TVSH, importues të mëdhenj dhe paguajnë tatimin e të ardhurave personale sipas metodës së të ardhurave reale dhe atë me qarkullim vjetor mbi 100.001,00 €	800.00	1.000.00		
2.	Hotelet	700.00	700.00		
3.	Restorantet	500.00	500.00		
4.	Restorant në fshatra	250.00	250.00		
5.	Kafiterit dhe bufet	250.00	200.00		

6.	Ndërmarrjet të cilët veprimtarinë e tyre biznisore e ushtrojnë me shitjen e materialit ndërtimor dhe realizojnë qarkullim vjetor mbi 50.000.00 €	350.00	500.00		
7.	Vend punishtet e ndërmarrjeve të cilët biznesin e tyre e ushtrojnë me prodhimin e materialit ndërtimor, gypave të plastikës, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, mobile si dhe prodhimet tjera të ngjashme.	350.00	350.00		
8.	Agjencionet turistike dhe agjencionet tjera të ngjashme të cilat krijojnë të hyra vetëm nga shitja e biletave të udhëtareve	200.00	200.00		
9.	Depot që bëjnë furnizime të artikujve të ndryshëm	350.00	350.00		
10.	Pompat e benzinës që selit e tyre i kanë në rrugën magjistrale Prishtinë-Prizren	700.00	800.00		
11.	Vetëshërbimet minimaketet	300.00	300.00		
12.	Subjektet afariste të cilat afarizmin e tyre e kanë të regjistruar si NT dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në Suharekë	200.00	200.00		
13.	Subjektet afariste të cilat afarizmin e tyre e kanë të regjistruar si DPT dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në Suharekë	200.00	190.00		
14.	Subjektet afariste NT që selit dhe aktivitetin biznisor e ushtrojnë në fshatra	150.00	150.00		
15.	Subjektet afariste DPT që selit dhe aktivitetin biznisor e ushtrojnë në fshatra	150.00	130.00		
16.	Serviset, automekaniket si dhe punëtorit tjera të ngjashme që aktivitetin e tyre biznisor e zhvillojnë në Suharekë.	250.00	250.00		
17.	Subjektet afariste të cekura si në piken 16 aktivitetin e tyre e zhvillojnë në e zhvillojnë	150.00	150.00		
18.	Barnatoret me pronësi shoqërore dhe individuale	350.00	350.00		
19.	Barnatoret të cilat janë të regjistruara në komunën tonë si njësi punuese ndërsa ndërmarrjen bazë e kanë të regjistruar jashtë territorit të komunës sonë	250.00	250.00		
20.	Ndërmarrjet dhe veprimtarit tjera të cilat nuk janë definuar më lartë që aktivitetin e tyre e ushtrojnë në fshatra	150.00	150.00		
21.	Subjektet afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonën e parë që nuk janë definuar më lartë	200.00	200.00		
22.	Çdo ndërmarrje me seli në Suharekë e cila shfrytëzon më tepër se një objekt afarist për aktivitete biznisore, për një vit për secilin objekt	100.00	100.00		
23.	Subjektet si nën piken 22 por me seli në fshat	50.00	50.00		
24.	Pompat e benzinës që ushtrojnë aktivitet biznisor në fshatra	450.00	400.00		

25.	Pompat e benzinës të cilat janë të regjistruar në komunën e Suharekës si njësi punuese ndërsa ndërmarrjes bazë e kanë të regjistruar jashtë territorit të komunës dhe që veprojnë në rrugën magjistrale Prishtinë-Prizren	450.00	750.00		
26.	Të gjitha njësit punuese që ndërmarrjen bazë i kanë të regjistruar jashtë territorit të komunës ngarkohen me 50% nga vlera e përgjithshme e ngarkesës totale	100.00	50%		
27.	Elektroservisat, autoelekticistat servist e TV	150.00	150.00		
28.	Prodhimi i blloqeve dhe elementeve te betonit	300.00	400.00		
29.	Thyerja dhe bluarja e gurit	350.00	350.00		
30.	Kompanitë e transportit të brendshëm dhe të jashtëm të udhëtareve dhe mallrave	400.00	400.00		
31.	Kompanitë e transportit urban dhe komunal të udhëtareve dhe mallrave	200.00	200.00		
32.	.Mullinjtë elektrik	350.00	350.00		
33.	Pishinat për larje dhe freskim	200.00	200.00		
34.	Fushat e sportit (stadiumet) etj.		150.00		

Vërejtje: Përveç lejes së rregullt për biznesit subjektet afariste që merren me shitjen e pijeve alkoolike janë të obliguar që të nxjerrin edhe leje tjetër plotësuese-speciale.

a) Subjektet afariste përveç obligimeve dhe ngarkesave tjera ngarkohen edhe me tarifa plotësuese më sa vijon.

1.	Shitja me shumicë e pijeve alkoolike	50.00	50.00		
2.	Shitja me pakicë e pijeve alkoolike	30.00	30.00		
3.	Hotelet	50.00	50.00		
4.	Restorantet, diskotekat dhe baret	50.00	50.00		
5.	Shitja me shumicë e birrës pa lloje tjera të alkoolit	50.00	50.00		
6.	Shitja me pakicë e birrës pa lloje tjera të alkoolit	30.00	30.00		

b) Subjektet afariste të cilët biznesin e tyre e ushtrojnë me shitjen e pijeve alkoolike me shumicë e pakicë në fshat ngarkohen me tarifa 50% më pak se ato në qytet.

Veprimtarit joekonomike

Nr./Ren. i Tarifës	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Norma tatimore në Euro " € "			
		Vendimi 2007	Propozimi i DEFZH	Propozimi i KPF-së	Aprovimi i KK-së
1.	Stacionet radio difuzive dhe TV	150.00	100.00		
2.	Ekspoziturat e bankave komerciale të të gjitha llojeve	600.00	1000.00		
3.	Bashkësitë e sigurimeve	500.00	500.00		
4.	Ekspoziturat (kompanitë) për sigurimin e personave, pasurisë dhe sigurime tjera të ngjashme	400.00	600.00		
5.	Kinematë private	100.00	100.00		
6.	Auto shkollat në pronësi shoqërore dhe private	300.00	250.00		
7.	Veprimtarit për pranim teknik të automjeteve	300.00	400.00		
8.	Expoziturat e PTT, distribucioni i energjisë elektrike me seli në Suharekë	600.00	1000.00		
9.	Ekspoziturat si nen piken 8 por me seli në fshat	300.00	400.00		
10.	Serviset e mobilave telefonike dhe të ngjashme	150.00	200.00		
11.	.Internet kafe	150.00	100.00		
12.	Ndërmarrjet individuale të cilat ushtrojnë aktivitete biznesore si kryerja e shërbimeve telefonike veprimtarit financiare që inkasojnë dhe transferojnë të hyrat publike.	250.00	300.00		
13.	Shërbimet dhe tregtia me pakicë e optikës	100.00	100.00		

Veprimtarit bujqësore

1.	Subjektet afariste që merren me shitjen e mekanizmit bujqësor	350.00	350.00		
2.	Subjektet afariste merren me qarkullimin e produkteve të bujqësisë	200.00	150.00		

Veprimtarit e pavarura profesionale

Nr./Ren. i Tarifës	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Norma tatimore në Euro " € "			
		Vendimi 2007	Propozimi i DEFZH	Propozimi i KPF-së	Aprovimi i KK-së
1.	Mishshitësit	300.00	250.00		
2.	Qebaptoret dhe gjellëbërësit	250.00	200.00		
3.	Bukëpjekësit	200.00	200.00		
4.	Ëmbëltoret, Byrektoret	100.00	100.00		
5.	Kafe-çajtore	100.00	100.00		
6.	Xhamaprerësit	150.00	150.00		
7.	Zdrukthëtarët	200.00	150.00		
8.	Teneqepunuesit dhe të ngjashme	200.00	150.00		
9.	Argjendarët	350.00	350.00		
10.	Rrojtoret, këpucarët, ngjyrosësit, rrobaqepësit si dhe të ngjashme	100.00	100.00		
11.	Salloni i femrave - frizere që aktivitetin e tyre e zhvillojnë në zonën e pare ngarkohen	200.00	200.00		
12.	Salloni i meshkujve- rrojtore që aktivitetin e tyre e ushtrojnë në zonën e parë	200.00	200.00		
13.	Vullkanizerët dhe larësit e automjeteve	100.00	100.00		
14.	Ekspoziturat e lotarive dhe lojërave me fat	200.00	200.00		
15.	Taxi shërbim	50.00	50.00		
16.	Taxi shërbim auto transportuese mbi 3.5 t	100.00	100.00		
17.	Ndërmarrjet, punëtoritë e pavarura, DPT që kanë të regjistruara subjektin e tyre afarist, dhe që nuk ushtrojnë kurrfarë veprimtarie ekonomike konform vërtetimit të gjendjes faktike	50.00	00.00		
18.	Subjektet afariste të cilët ushtrojnë veprimtari të ndryshme lojëra të fatit apo lojëra të tjera për kohë të caktuar janë të obliguar të paguajnë tarifë ngarkesën ditore	5.00	5.00		
19.	Për vënien e shenjave tabelave me qëllim të propagandës dhe reklamave jashtë objektit afarist për çdo metër apo m ² përveç ngarkesave paguhet edhe tarifa vjetore për propagandë dhe reklama	50.00	50.00		
20.	Video klubet, incizuesit, shumëzuesit si dhe veprimtaritë e tjera të ngjashme	50.00	50.00		
21.	Organizuesi i estradës muzikore për çdo manifestim ditor paguan pos tarife ngarkesës vjetore edhe tarifë ngarkesën ditore	50.00	50.00		
22.	Veprimtarit e fotografimit	200.00	200.00		

a) Dispozitat e veçanta:

a.a Subjektet afariste që nuk kanë ushtruar kurrfarë aktiviteti biznesor për vitet: 2000, 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2008 e të cilët dëshirojnë ta çregjistrojnë subjektin e tyre afarist, do të paguaj shumën vjetore 10.00 € për një Subjektet afariste janë të obliguar të dëshmojnë certifikatën nga administrata tatimore që nuk kanë ushtruar kurrfarë veprimtarie ekonomike, formularët e deklarimit të tatimit me qarkullim 0 dhe pagesë 0 gjendjen e tatimpaguesit me qarkullim të deklaruar për çdo tremujor të periudhës që nuk kanë ushtruar biznes afarist.

Vërtetimin e gjendjes faktike për mos ushtrim të veprimtarisë ekonomike konfirmohet nga ana e komisionit profesional të Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, i cili komision caktohet nga ana e Ekzekutivit të Komunës së Suharekës.

a.b. Të gjitha subjektet afariste të cilat kanë ushtruar aktivitet biznesor për vitin 2000, përcaktimet e detyrimeve të i'u përcaktohen në bazë të shifrës kryesore të veprimtarisë dhe konstatimit të gjendjes faktike nga ana e komisionit të DEFZH.

a.c. Subjekti afarist i cili ushtron përkohësisht aktivitetet biznesor si nën piken 18 janë të obliguar që ta lajmëroj DEFZH, lidhur me fillimin e ushtrimit të biznesit në të kundërtën i ndërprehet ushtrimi i veprimtarisë ekonomike.

a.q Organizuesi (subjekti afarist) është i obliguar paraprakisht të lajmëroj Drejtorinë për fillimin e organizimit të manifestimit muzikor dhe t' i përmbush detyrimet si nën piken 21 të kësaj Rregullore.

Për zbatimin e dispozitës si nën piken 21 përkujdeset Inspekcioni i Drejtorisë së Inspekcionit të komunës së Suharekës.

Dhënia e Pëlqimit bëhet nga Drejtorati për Ekonomi dhe Financa.

Veprimtarit profesionale

Për realizimin e veprimtarisë profesionale në territorin e komunës së Suharekës, kërkohet leje e veçantë për të vepruar, bazuar në standardet mbi vërtetimin e profesionit, kualifikimin përkatës shkollor apo vërtetimin për trajnimin përkatës në bazë të cilave personi mund të përcaktoj veprimtarinë profesionale dhe njohja nga autoriteti rregullues shtetëror apo profesional për këto veprimtari profesionale.

(a) Tarifat për lëshimin e lejes së lartpërmendur do të paguhet në llogarinë e komunës në baza vjetore dhe sipas këtyre tarifave vjetore.

Nr./Ren. i Tarifës	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Norma tatimore e qirasë në " € "			
		Vendimi 2007	Propozimi i DEFZH	Propozimi i KPF-së	Aprovimi i KK-së
1.	Avokatët, shërbimet juridike dhe përkthyesit	400.00	350.00		
2.	Ordinancat private, stomatologet dhe mjeket	400.00	350.00		
3.	Subjektet si nën piken 2 me seli në fshat	300.00	250.00		
4.	Fizioterapistët	300.00	250.00		
5.	Laboratorët		250.00		
6.	Kontabilistët	100.00	100.00		
7.	Ndërmarrjet projektuese dhe profesionale dhe te ngjashme	400.00	400.00		

Vërejtje: kërkesa për leje të punës dhe leje profesionale paguhet në shumë prej 10.00 €

Tarifat për dhënien e lejes së veçantë gjatë ditëve të vikendit dhe me gjatë se orari i plotë i punës

Subjektet të cilat dëshirojnë të punojnë gjatë ditëve të vikendit duhet të marrin leje të veçantë nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa është e obliguar ta njoftoj me shkrim Drejtorin e Inspeksionit për çdo leje të dhënë.

(a) Drejtoria për Ekonomi dhe financa mund të lëshoj leje duke marrë për bazë kriteret që të përfshinë të gjitha laxhet e qytetit:

1.	Subjektet afariste të cilët merren me shitjen e karburanteve	100.00	100.00		
2.	Subjekte afariste të cilat merren me shitjen e artikujve ushqimor	100.00	100.00		
3.	Ndërmarrjet ndërtimore	100.00	100.00		

Vërejtje: Subjektet afariste të cilët aktivitetin e tyre biznesor e ushtrojnë në periferi nga rruga magjistrale ngarkohen 50% më ultë se tarifat e cekura më lartë.

Të gjitha ato subjekte që shprehin dëshirë dhe nevojë për të punuar ditëve të vikendit mund të bëjnë kërkesë Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa e njëjta do të shqyrton kërkesën dhe mund të jep leje me pagesë nga ai subjekt prej 50 -100 Euro në muaj

(b) Tarifat për çdo orë pune më gjatë se orari i punës duhet paguar :

1.	Objektet hoteliere (restorantet, kafe- baret, dyqanet hoteliere	20.00	20.00		
2.	Supermarketet vetëshërbimet	15.00	15.00		
3.	Dyqanet tregtare	10.00	10.00		
4.	Ndërmarrjet ndërtimore	20.00	20.00		
5.	Ordinancat private	10.00	10.00		

Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të transaksioneve (shitblerjeve) të paluajtshmërive, transferin e pasurisë, dhuratave dhe trashëgimive, caktohen në mbështetje të Udhëzimit administrativ NR AKK 2006/1

1.	Për vlerën e transaksionit deri në 10.000.00 €	20.00	20.00		
2.	Për vlerën e transaksionit prej 10.000.00 € deri në 20.000.00 €	30.00	30.00		
3.	Për vlerën e transaksionit prej 20.000.00 € deri në 40.000.00 €	40.00	40.00		
4.	Për vlerën e transaksionit prej 40.000.00 € deri në 50.000.00 €	50.00	50.00		
5.	Mbi vlerën e 50.000.00 €, për çdo 10.000.00 € tejkalim Por shuma e tarifës së përgjithshme nuk mund ta kalojë vlerën 200.00 €	10.00	10.00		
6.	Po qe se vlera e kontratës-transaksionit është e pa vlerësueshme	70.00	70.00		

Tarifat për lejet e pronësisë së automjeteve

Të gjithë pronarët, bizneset ose entitete tjera që kanë në pronësi të tyre të gjitha llojet e automjeteve motorike që regjistrohen dhe paguajnë sigurimin e automjeteve brenda vitit i caktohet ngarkesa më sa vijon:

Automjetet deri në 3.5 ton ngarkohen	10.00	10.00		
Automjete mbi 3.5 ton ngarkohen	20.00	20.00		

Tarifat për lëshimin e lejes së lartpërmendur do të paguhet në Komunë me ngarkesë dhe në bazë vjetore ose me rastin e regjistrimit të automjeteve në qendrën për regjistrimin e automjeteve.

Dispozitat e veçanta

Nga ngarkesa për leje të automjeteve motorike lirohen të gjitha automjetet e emergjencës (zjarrfiksat dhe makinat e ndihmës së shpejtë), invalidët (punës, civilë dhe ushtarakë), individët me aftësi të kufizuar. Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit.

Vërejtje: Paguesa e ngarkesës për lejen e pronësisë së automjeteve motorike bëhet më rastin e regjistrimit të tyre në qendrën për regjistrimin e automjeteve ose pranë Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa – Sektori i Financave.

Kontrollin për mos pagesë eventuale të ngarkesës për leje të pronësisë së automjeteve motorike e bënë inspekcioni si dhe SHPK.

Tarifat për parkimin e automjeteve

1.	Tarifat për automjetet motorike deri në 3.5 t për një orë	1.00	1.00		
2.	Tarifat për automjetet motorike mbi 3.5 t për një orë	2.00	2.00		
3.	Tarifat për kampe shtëpiza në ditë	5.00	5.00		

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare

1.	Çertifikat mbi kryerjen e obligimeve dhe Çertifikata të ngjashme	1.00	1.00		
2.	Çertifikatat për kursime pensionale invalidore (zejtarët).	1.00	1.00		
3.	Çertifikata për gjendjen ekonomike dhe financiare	1.00	1.00		
4.	Për mbajtjen e muzikës në lokale publike paguhet taksa ditore	15.00	15.00		
5.	Kërkesat për zvogëlimin e tarifë ngarkesave	1.00	1.00		
6.	Vërtetimet e kontratave për shkëputjen e bashkësisë familjare	5.00	5.00		

Neni 5.

Tarifat në sferën e shëndetësisë dhe çështjen sociale

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENJES SOCIALE

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kjo Drejtori realizon këto të hyra për tarifat dhe ngarkesat për qytetaret e Komunës së Suharekës:

Nr./Ren. i Tarifës	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Norma taksave në Euro " € "			
		Vendimi 2007	Propozimi i DSHMS	Propozimi i KPF-së	Aprovimi i KK-së
1.	Vërtetimi për nxënës dhe studentë për botën e jashtme:	5.00	5.00		
2.	Vërtetimet mbi gjendjen shëndetësore të punëtorëve në botën e jashtme:	10.00	10.00		
3.	Vërtetimet e llojeve të ngjashme që nuk cekën në pikën 1 dhe 2:	10.00	10.00		
4.	Raporte konziliare të mjekëve për punëtor në botën e jashtme:	20.00	20.00		

Dispozitat veçanta

Lirimi nga tarifat dhe ngarkesat:

Familja e ngushtë e dëshmoreve (bashkëshortet, fëmijët dhe prindërit e tyre) lirohen nga pagesa në numrin 2 tarifor të nenit 1.

Gjithashtu studentët dhe nxënësit lirohen nga pagesa në tarifë ngarkesa që kanë lidhje me shkollimin e tyre.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Bazuar në nenin 12.7 të Ligjit për Shëndetësinë nr.2004/4 dhe Udhëzimit Administrativ 2006/6 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe Aktvendimit të Ekzekutivit të Komunës së Suharekës, drejtori i QKMF nxjerr:

a) Me anë të kësaj rregullore përcaktohen dhe sigurohen të gjitha të hyrat financiare nga bashkë pagesat që realizohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Suharekë, nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, si dhe dispozitat e veçanta me anë të cilave parashihen kategoritë e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore që përjashtohen këto bashkë pagesa.

b) Me dispozita ligjore dhe udhëzime administrative në fuqi shfrytëzuesit potencial (që në ndonjë mënyrë nuk janë liruar nga shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore) janë të obliguar të paguajnë tarifë ngarkesën për ofrimin e shërbimit shëndetësor në QKMF. Këta shfrytëzues të shërbimeve shëndetësore obligohen të participojnë për këto shërbime të paraqitura në mënyrë tabelare:

Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në mjekësinë e përgjithshme

Nr./Ren. i Tarifës	EMËRTIMI LLOJI I SHËRBIMIT	Norma taksave në Euro " € "			
		Vendimi 2007	Propozimi i DSHMS	Propozimi i KPF-së	Aprovimi i KK-së
1.	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00	1.00		
2.	Ekzaminimi mjekësor në QMF/QKMF me udhëzim të mjekut të familjes	2.00	2.00		
3.	Ekzaminimi mjekësor në QMF/QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes	4.00	4.00		
4.	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00	6.00		
5.	Medikamenti nga Lista Esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.30	0.30		
6.	Ultrazëri standard	2.00	2.00		
7.	Radiografia	2.00	2.00		
8.	EKG	0.50	0.50		
9.	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina	1.00	1.00		
10.	Analizat laboratorike (komplet)	3.00	3.00		
11.	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00	1.00		
12.	Audiograma	1.00	1.00		
13.	Shpëlarja e veshit	1.00	1.00		
14.	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00	1.00		
15.	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00	1.00		
16.	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërimin e plagës (vetëm në vizitën e pare)	3.00	3.00		
17.	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00	1.00		
18.	Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i mjekëve	18.00	18.00		
19.	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00	18.00		
20.	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00	5.00		
21.	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj-për një orë	25.00	25.00		
22.	Çdo pacienti të cilit i ofrohet shërbim shëndetësor në urgjencë nga ora 20 ⁰⁰ deri në ora 8 ⁰⁰ pa marr parasysh moshën	1.00	1.00		

23.	Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë sesa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkë pagesë në lartësi prej 2 € shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguaj 10 €				
-----	--	--	--	--	--

Çmimorja për tarifatat dhe ngarkesat në shërbimet stomatologjike

Nr./Ren. I Tarifës	EMËRTIMI LLOJI I SHËRBIMIT	Norma taksave në Euro " € "			
		Vendimi 2007	Propozimi i DSHMS	Propozi mi i KPF-së	Aprovimi i KK-së
1.	Vizita e pare stomatologjike	1.00	1.00		
2.	RTG i dhëmbit	1.50	1.50		
3.	Mbushja e përhershme me amalgamë	4.00	4.00		
4.	Mbushja e përhershme me kompozitë	5.00	5.00		
5.	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme(amalgamë apo kompozitë)	5.00	5.00		
6.	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00	6.00		
7.	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00	6.00		
8.	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00	6.00		
9.	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00	6.00		
10.	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00	6.00		
11.	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00	6.00		
12.	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00	1.00		
13.	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00	1.00		
14.	Vulosja e fisurave	1.00	1.00		
15.	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00	1.00		
16.	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00	3.00		
17.	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmbë)	1.00	1.00		
18.	Nxjerrja e dhëmbit	1.50	1.50		
19.	Incizioni intra dhe ekstra oral	1.50	1.50		
20.	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00	1.00		
21.	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50	1.50		
22.	Me dispozitat e tarifë ngarkesave të Komunës për shfrytëzimin e lokaleve me Qira, QKMF për një metër 2 (katror) realizon 5 € (Euro), me shfrytëzuesit e lokaleve të QKMF-së në ato lokacione ku shprehet interesi.	5.00 m ²	5.00 m ²		

23.	Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë sesa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkëpagesë në lartësi prej 2 € shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguaj 10 €				
-----	---	--	--	--	--

Dispozitat e veçanta

Përfshirimi nga bashkë pagesat (tarifë ngarkesave)

Shërbimet shëndetësore dhe grupet e popullatës që janë të liruar nga bashkë pagesat:

1. Fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 15 vjeçare;
